

URDHËR
Nr. 157, datë 21.4.2015

**PËR LICENCIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV PËR TË DREJTAT
E ARTISTËVE INTERPRETË DHE/OSE EKZEKUTUES TË VEPRAVE, ME TË
GJITHA FORMAT E PËRCJELLJES SË INTERPRETIM/EKZEKUTIMIT TË TYRE NË
PUBLIK, "AKDIE"**

Duke marrë parasysh propozimin nr. 394, prot. datë 15.4.2015 të Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, për licencimin të agjencisë "AKDIE" për të ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e artistëve interpretë dhe/ose ekzekutues të veprave, me të gjitha format e përcjelljes së interpretim/ekzekutimit të tyre në publik,

KONSTATOVA SE:

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9380, datë 28.4.2005, "Për të drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", të ndryshuar, është kompetencë e ministrit të Kulturës miratimi i dhënies së licencës kësaj agjencie në fushën e menaxhimit kolektiv të të drejtave të artistëve interpretë dhe/ose ekzekutues të veprave, me të gjitha format e përcjelljes së interpretim/ekzekutimit të tyre në publik, AKDIE.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të pikës 1 të nenit 108 dhe pikave 1 dhe 3 të nenit 109, të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv për të Drejtat e Artistëve Interpretë dhe/ose Ekzekutues të veprave, me të gjitha format e përcjelljes së interpretim/ekzekutimit të tyre në publik, AKDIE.
2. Afati i licencës është 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro (Furxhi)